



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVË DHE REKREACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. _____ prot.

Tiranë më, _____, _____, 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Drejtuar: Operatorit ekonomik: “K.KORRA” SH.P.K

Adresa: Labinot fushë MENGEL, rruga Elbasan-Librazhd km-2, zona kadastrale 2654, pasuria A. Elbasan

* * *

Tipi i Kontratës: **Kontratë për Shërbim**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **NR-REF-22719-10-03-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Evadimi i mbeturinave në ngastrat e mbuluara me pishë në ngastrat dhe nëngastrat ”Allgjatë, Baldushk, Pezë”**
(Prejje Shëndetsore dhe evadimi i materialit drusor të rrëzuar dhe tharë nga rënia e zjarrit)

Kohëzgjatja e kontratës: Afati i shërbimit do të jetë: 6 (gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: Datë 04/10/2024

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike :Buletini Nr.67, datë 7 Tetor 2024

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “K.KORRA” SH.P.K

NIPT-t: K12526208G

Vlera e ofertës: 10,938,395 (dhjetëmilion e nëntëqind e tridhjetë e tetëmijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa Tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor

2. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” Sh.p.k NIPT-t: **K91413010N**

Vlera e ofertës: 10,978,950 (dhjetëmilion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë)lekë pa Tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” Sh.p.k NIPT-t: K91413010N

Vlera e ofertës: 10,978,950 (dhjetëmilion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë)lekë pa Tvsh

për arsyet e mëposhtme

a) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta te kualifikimit”, Kapaciteti Teknik pika 2.3.1 percaktohet sa me poshte vijon:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe konkretisht jo më të vogël se vlera: 4.654.636 (katërmilion e gjashtëqind e pesëdhjetë e katërmijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në plotësim të këtij kriteri konstatohet se është paraqitur dokumentacioni sa më poshtë vijon:

- Kontratë me Ndërmarrjen Industriale Nr.1 me objekt “Shërbim gjelbërimi për polin e drejtesise” në vlerën 2.318.400 lek pa tvsh.

Në kontratë përcaktohet se operatori ekonomik do të realizojë sa më poshtë:

Oborr i jashtëm gjelbërim =2300 m²

Oborr i brendshëm gjelbërim=500 m²

Shërbimet që do të realizohen sipas kontratës janë:

Kositja, krasitja, mbjellja

Krasitja e pemëve

Ujitja/vaditja e pemëve, bimëve dhe luleve

Prerja e degëve të thata pemëve dhe shkurreve

Korrja e barit

Zëvendësim i pemëve, bimëve dhe luleve të dëmtuara

Sistemim dhe heqje mbeturinash nga krasitja dhe prerja e pemëve dhe shkurreve.

Konkretisht, kontrata e paraqitur sa më sipër nga Pastrime Silvio sh.p.k, nuk mund të konsiderohet si kontratë e ngjashme pasi nuk përmbush karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga operatori ekonomik nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Produkti që kërkohet në objektin e prokurimit është, prerja e drurëve të shkullur, të tharë nga zjarri, pastrim i mbeturinave dhe vendosja në breza në distancë 25-30 ne pyje ndërkohë që punimet e ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik janë kryesisht punime gjelberimi të oborreve të brendshëm dhe të jashtëm. Komisioni konstaton se, operatori ekonomik ka dështuar të provojë përmes kësaj kontrate se ka kryer punime të ngjashme dhe se disponon eksperiencën e nevojshme për realizimin e shërbimeve të ndërhyrjes në pyje të cilat kërkojnë ekspertizë dhe eksperincë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga operatori ekonomik me anë të kontratës së sipërcituar.

- Kontratë e realizuar me repartin special Renea me objekt “Shërbim dezinfektimi dhe mirëmbajtje të gjelbërimit” ne vleren 790.000 lek pa tvsh.

Kontrata e paraqitur sa më sipër nga Pastrime Silvio sh.p.k, nuk mund të konsiderohet si kontratë e ngjashme pasi referuar zërave të preventivit ka zera kositje bari, transport bari, dezifektim, deratizim, dezinspektim zera të cilët nuk janë të ngjashëm me kontratën objekt prokurimi. Komisioni konstaton se, operatori ekonomik ka dështuar të provojë përmes kësaj kontrate se ka kryer punime të ngjashme dhe se disponon eksperiencën e nevojshme për realizimin e shërbimeve të ndërhyrjes në pyje të cilat kërkojnë ekspertizë dhe eksperincë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga operatori ekonomik me anë të kontratës së sipërcituar.

- Kontrate me Ministrinë e Mjedisit me objekt: “Shërbim mirëmbajtje dhe zevendesim të bimëve dekorative në ambjentet e jashtme dhe të brendshme” me vlere 755.400 leke pa tvsh.

Kontrata e paraqitur sa më sipër nga Pastrime Silvio sh.p.k, nuk mund të konsiderohet si kontratë e ngjashme pasi pasi nuk përmbush karakteristikat e kontratës në natyrën e saj. Në këtë kontratë operatori ekonomik ka marrë përsiper zëvendësimin e bimëve dekorative dhe mirëmbajtjen e tyre dhe nuk mund të konsiderohet e ngjashme. Komisioni konstaton se, operatori ekonomik ka dështuar të provojë përmes kësaj kontrate se ka kryer punime të ngjashme dhe se disponon eksperiencën e nevojshme për realizimin e shërbimeve të ndërhyrjes në pyje të cilat kërkojnë ekspertizë dhe eksperincë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga operatori ekonomik me anë të kontratës së sipërcituar.

- Kontrate me Ministrinë e Mjedisit me objekt: “Shërbim mirëmbajtje dhe zevëndësim të bimëve dekorative në ambjentet e jashtme dhe të brendshme” me vlere 849.900 leke pa tvsh.

Kontrata e paraqitur sa më sipër nga Pastrime Silvio sh.p.k, nuk mund të konsiderohet si kontratë e ngjashme pasi pasi nuk përmbush karakteristikat e kontratës në natyrën e saj. Në këtë kontratë operatori ekonomik ka marrë përsipër zëvendësimin e bimëve dekorative dhe mirëmbajtjen e tyre dhe nuk mund të konsiderohet e ngjashme. Komisioni konstaton se, operatori ekonomik ka dështuar të provojë përmes kësaj kontrate se ka kryer punime të ngjashme dhe se disponon eksperiencën e nevojshme për realizimin e shërbimeve të ndërhyrjes në pyje të cilat kërkojnë ekspertizë dhe eksperincë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga operatori ekonomik me anë të kontratës së sipërcituar.

- Kontratë me Tirana Agrikulture me objekt: “Shërbime të pastrimit, dezinfektimit dhe gjelbërimit për nevoja të Tirana Agrikulture” me vlere 3.107.755 leke pa tvsh.

Kontrata e paraqitur sa më sipër nga Pastrime Silvio sh.p.k, nuk mund të konsiderohet si kontratë e ngjashme pasi pasi nuk përmbush karakteristikat e kontratës në natyrën e saj. Në këtë kontratë operatori ekonomik ka marrë përsiper shërbime të pastrimit, dezinfektimit dhe gjelbërimit dhe nuk mund të konsiderohet e ngjashme. Komisioni konstaton se, operatori ekonomik ka dështuar të provojë përmes kësaj kontrate se ka kryer punime të ngjashme dhe se disponon eksperiencën e nevojshme për realizimin e shërbimeve të ndërhyrjes në pyje të cilat kërkojnë ekspertizë dhe eksperincë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga operatori ekonomik me anë të kontratës së sipërcituar.

Komponentët të cilët karakterizojnë kontratën objekt-prokurimi, kërkojnë eksperiencë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga shoqëria “Pastrime Silvio” SHPK me anë të dokumentacionit të sipërcituar, referuar specifikimeve teknike dhe komponentëve përbërës të tyre. Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon, se krahasueshmëria e eksperiencave të mëparshme nëse janë të ngjashme, nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë për shërbime, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën, duke iu referuar qëllimit të kërkesës për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Komisioni konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të ofruar, duke nisur që nga objekti i kontratave të ofruara, rezulton, se këto kontrata nuk mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit. Në këtë kuptim, Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon, se operatori ekonomik me dokumentacionin e paraqitur, nuk provon, se ka kryer shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “K.KORRA” SH.P.K, me adresë: Labinot fushë MENGEL, rruga Elbasan-Librazhd km-2, zona kadastrale 2654, pasuria A. Elbasan se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 10,938,395 (dhjetëmilion e nëntëqind e tridhjetë e tetëmijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa Tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.